



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA CËRRIK

KRYETARI

Nr. 845 Prot

Cerrik 07.04.2025

URDHËR

Nr. 94 Date 07.04.2025

PËR PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE TË LEJUARA PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET E DATËS 11.05.2025 PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË.

Në mbështetje të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar neni 79, Udhëzimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Nr.6, datë 23.03.2021, "Përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore" i ndryshuar,

URDHËROJ

1. Përcaktimin e vendeve publike të lejuara në territorin e Bashkisë Cërrik për afishimin e materialeve edukative zgjedhore dhe propagandistike nga subjektet zgjedhore në mënyrë proporcionale, hapësirë kjo që siguron shikueshmërinë publike.
2. Materialet propagandistike zgjedhore dhe sendet e lejuara për fushatë zgjedhore lejohen të afishohen vetëm deri në një distancë prej 5 (pesë) metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës dhe jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve.
3. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit, shtyllat e ndriçimit dhe mjetet që operojnë në transportin publik.
4. Të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: "Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të..." (vijon emri i subjektit zgjedhor).

5. Subjektet zgjedhore duhet të njoftojnë me shkrim Kryetarin e Bashkisë për hapjen e zyrave zgjedhore me adresat e sakta të tyre, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve.
6. Partitë politike dhe subjektet zgjedhore duhet t'i përmbahen dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe Udhëzimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe me mbarimin e fushatës zgjedhore, të marrin masat për heqjen e të gjitha materialeve propagandistike.
7. Policia bashkiake ngarkohet me detyrë për të garantuar zbatimin e këtij vendimi, për të mos lejuar, për të hequr menjëherë çdo material statik përfshirë posterat dhe flamujt nga çdo vendndodhje tjetër kur konstatohet që nuk janë vendosur në përputhje me kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe Udhëzimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
8. Ky vendim i dërgohet për njohje Prefektit të Qarkut Elbasan dhe Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut Elbasan.
9. Ky vendim publikohet në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit dhe një kopje e tij i njoftohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

